



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.2 Regj.Them.
Datë Rregj.22.02.2021

Nr.2 VENDIMI
Datë 04.03.2021

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor i mbledhur pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë me trup gjykues të përbërë nga:

Gjyqtare: **Esmeralda XHILI (ÇEKA)** (*Relatore*)
Gjyqtar: **Asim VOKSHI** (*Anëtar*)
Gjyqtar: **Sokol IBI** (*Anëtar*)
Gjyqtare: **Alma KOLGJOKA** (*Anëtare*)
Gjyqtar: **Gentjan MEDJA** (*Anëtar*)

me sekretare gjyqësore Ermelinda Nuraj, sot më datë 04.03.2021, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr.2 .akti, datë 22.02.2021 që i përket:

PADITËS: **Partia Lëvizja Socialiste për Integrim**, përfaqësuar nga Kryetari Znj. Monika Kryemadhi, me adresë: Rruga "Samë Frashëri" Nr.20/10, Tiranë, përfaqësuar me autorizim me nr. 118 prot. datë 22.02.2021, nga Av.Altin Kaziaj, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë me licensë me nr.6558.

IPADITUR: **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**, përfaqësuar në gjykim me autorizim me nr.1685 prot. datë 04.03.2021 nga Z.Erion meto dhe Z.Olsi Peto.

PERSON I TRETË: **Erion VELIAJ** Kryetar i Bashkisë Tiranë, përfaqësuar me prokurë të posaçme me nr.3044 rep. 1155 kol. Datë 04.03.2021 nga Av.Maringlen Legisi, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë me nr.5191 license.

OBJEKTI: Ndryshimi i vendimit nr. 6, datë 16.02.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve.

BAZA LIGJORE: Neni 145 e vijues i Kodit Zgjedhor të RSH, Vendimi nr. 9, datë

24.12.2020 i Komisionit Rregullator.

Kolegji Zgjedhor, në seancën e datës 04.03.2021, pasi dëgjoi kërkesat paraprake të palëve, ku pala e paditur dhe personi i tretë, nëpërmjet përfaqësuesve respektivë mbajtën qëndrimin që Kolegji Zgjedhor nuk është kompetent për shqyrtimin e kësaj kërkesëpadie; pasi u njoh me qëndrimin e palës paditëse, përfaqësuesit përkatës, sipas të cilit, kompetenca për shqyrtimin e kësaj kërkesëpadie i takon Kolegjit Zgjedhor,

VËREN:

1. Se pala paditëse, subjekti Partia Lëvizja Socialiste për Integrim i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor, duke depozituar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, padinë me objekt *“Ndryshimi i vendimit nr. 6, datë 16.02.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve.”*. Referuar përcaktimeve të Kodit Zgjedhor, brenda afatit ligjor, u caktua seanca për gjykimin e kërkesëpadisë së paraqitur, duke iu kërkuar edhe palës së paditur paraqitja e të gjithë dokumentacionit përkatës, lidhur me vendimmarrjen që kundërshtohet nëpërmjet kësaj kërkesëpadie. Në fazën e kërkesave paraprake, pala e paditur Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve dhe personi i tretë Erion Veliaj parashtruan se Kolegji Zgjedhor nuk është kompetent për shqyrtimin e padisë. Ndërkohë që, qëndrimi i palës paditëse Partia Lëvizja Socialiste për Integrim ishte i ndryshëm, duke parashtruar se përkundrazi, pikërisht Kolegjit Zgjedhor i takon kompetenca për shqyrtimin e kësaj kërkesëpadie.

I. FAKTET E ÇËSHTJES:

2. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në datat 27.12.2020, 30.12.2020, 05.01.2021 dhe 09.01.2021 janë raportuar nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim disa denoncime në ndërfaqen e *“Aktiviteteve të Ndaluara”*, në rubrikën *“Kallëzo”*, për veprimtaritë e Kryetarit të Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj, i cili në llogarinë e tij personale në FACEBOOK, ka publikuar disa foto dhe video me qytetarë të ndryshëm duke mbështetur dhe promovuar objekte të rindërtuara ose në proces rindërtimi për shkak të fatkeqësive natyrore.

3. Kallëzimet e paraqitura nga subjekti politik LSI janë kryer dhe janë regjistruar në sistem elektronik të KQZ dhe identifikohen me numër unik të gjeneruar nga sistemi. Kallëzimet e bëra në ndërfaqe/ portal deri me datën 18.1.2021 për këtë subjekt janë si vijon:

- Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 353, datë 30.12.2020;
- Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 360, datë 30.12.2020;
- Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 362, datë 30.12.2020;
- Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 404, datë 05.01.2021;
- Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 406, datë 05.01.2021;
- Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 562, datë 09.01.2021;
- Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 570, datë 09.01.2021;
- Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 574, datë 09.01.2021 9;
- Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 578, datë 09.01.2021;
- Kallëzim me numër ID të gjeneruar nga sistemi 580, datë 09.01.2021;

4. Në vijimi të denoncimit, pas kryerjes së hetimit administrativ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin Nr.46, datë 09.02.2021, ka vendosur:

1. Sanksionin administrativ me gjobë ndaj z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë në shumën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për shkelje të nenit 92 pikat 1, 2 e 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar për mosraportim të aktiviteteve publike.
2. Sanksionin administrativ me gjobë ndaj z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë në shumën 40 000 (dyzetë mijë) lekë për shkelje të nenit 3, paragrafi 1.3, shkronja “b”, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.

5. Kundër vendimit nr. 46, datë 09.02.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve ka bërë ankim z. Erion Veliaj, i cili në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se: *Bashkisë Tiranë i lind detyrimi të bëjë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet si rrjedhojë e procesit të rindërtimit, çka nënkupton se këto veprimtari nuk përbëjnë promovim të objekteve të rindërtuara apo në proces rindërtimi. Këto procese nuk përmbushin cilësitë e nevojshme për t’u konsideruar si veprimtari/aktivitet me karakter publik dhe promovues, pasi nuk janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion apo janë transferuar fonde publike, jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve, por janë ndjekur/zbatuar në vazhdimësi, sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore. Të gjitha këto aktivitete, nisur nga vendimi nr. 9/2020, janë zhvilluar vetëm me pjesëmarrjen e pjesëtarëve të familjeve përfituese dhe të një numri shumë të kufizuar të stafit të bashkisë Tiranë. Në asnjë rast nuk kanë qenë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias në kuptim të nenit 92 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.*

Bashkia Tiranë parashtron se ka dërguar email me objekt “Raportim i veprimtarisë publike të Bashkisë Tiranë” në adresën postare elektronike të vendosur në vendimin nr. 09/2020 (raportime.institucione@kqz.gov.al) për raportimin e aktiviteteve, sepse e kishte të pamundur të aksesonte ndërfaqen. Ky e-mail është kthyer pas, pasi adresa e e-mailit nuk mund të gjendej dhe rezultonte e pasuksesshme.

Ankuesi parashtron gjithashtu se asnjë prej banesave të inspektuara përgjatë aktiviteteve, nuk iu është dhënë certifikata e pronësisë; nuk është detyra dhe funksioni i kryetarit të bashkisë dhënia e dokumentit të pronësisë së banesave të dëmtuara. I vetmi dokument i pretenduar ka qenë marrja në dorëzim e punimeve nga kontraktori i punimeve të Bashkia Tiranë, dokument i depozituar si provë nga ankuesi. Për sa më sipër, përfaqësuesi ligjor i ankuesit ka kërkuar pranimin e ankimit dhe ndryshimin e vendimit nr. 46/2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve”.

6. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve në përfundim të hetimit administrativ, ka disponuar me vendimin nr.6, datë 16.02.2021, bazuar në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, me shumicë votash, ka vendosur:

1. *Ndryshimin e vendimit nr. 46, datë 09.02.2021 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ ndaj kryetarit të bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj”;*
2. *Për pikën 1 të vendimit të KSHZ nr. 46/2021, shfuqizimin e sanksionit administrativ me gjobë ndaj z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë, në shumën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për shkelje të nenit 92 pikat 1, 2 e 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar për mosraportim të aktiviteteve publike;*

3. Për pikën 2 të vendimit nr. 46/2021, të KSHZ, shfuqizimin e sanksionit administrativ me gjobë ndaj z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë në shumën 40 000 (dyzetë mijë) lekë për shkelje të nenit 3, paragrafi 1.3, shkronja “b”, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020....

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve ka arsyetuar:

Komisioni Rregullator në KQZ, më datë 24.12.2020 ka miratuar vendimin nr. 9 “Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”. Ky vendim, në nenin 4 të tij, përcakton detyrimin e institucioneve publike për të kryer raportimin në ndërfaqen raportimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ndërsa pika 5 e këtij vendimi sanksionon se subjektet raportuese mund ta dërgojnë raportimin nëpërmjet e-mail-it zyrtar në adresën raportime.institucione@kqz.gov.al ose nëpërmjet shërbimit të shpejtë postar.

Me shkresën nr. 2616 prot., datë 24.12.2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në respektim të kërkesave të këtij vendimi i ka kërkuar Bashkisë Tiranë caktimin e personit të kontaktit me qëllim raportimin e veprimtarive publike. Konfirmimi i personit të kontaktit është dërguar me shkresën nr. 5402 prot, datë 02.02.2021 të Bashkisë Tiranë, administruar në KQZ me shkresën nr. 827 prot, datë 03.02.2021. Sipas kartelës shoqëruese të praktikës (depozituar si provë nga Ankuesi E.Veliaj), në datën 31.12.2020 praktika i është dërguar për ndjekje Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licensimit. Rezulton e provuar se Drejtori i kësaj Drejtorie z. A. Dokushi ka filluar të raportojë në ndërfaqen e KQZ nga data 07.01.2021 e në vijim.

Referuar shkresës nr. 5402 prot, datë 02.02.2021 të Bashkisë Tiranë, si dhe në zbatim të nenit 92, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, që përcakton se “Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (sekretarit të përgjithshëm të institucionit ose, sipas rastit, e drejtorit të përgjithshëm apo drejtorit ekzekutiv)”, rezulton se Kryetari i Bashkisë Tiranë nuk është personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive me karakter publik të Bashkisë Tiranë.

Referuar nenit 3, pika 1, të ligjit nr. 111/2018 ‘Për kadastrën’, aktet kadastrale janë dokumentet zyrtare unike që Agjencia Shtetërore e Kadastrës lëshon për çdo pronar të pasurive të paluajtshme ose titullar të të drejtave reale mbi to. Këto akte përfshijnë: certifikatat, vërtetimet, ekstrakte të kartelës kadastrale, hartës kadastrale dhe akte të tjera të parashikuara në këtë ligj. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se dokumentet e pretenduara nga Kallëzuesi LSI, si dokumente pronësie të dorëzuara nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, janë procesverbalet e marrjes paraprake në dorëzim të objektit, që mbahen midis palëve që kryejë punimet (Kontraktori, Mbikqyrësi), përfaqësuesve të Bashkisë, si dhe qytetarit që nënshkruan si përfitues i objektit të banimit. Referuar nenit 3 të Vendimit numër 9/2020 të Komisionit Rregullator mbajtja e këtyre procesverbaleve nuk konsiderohet veprimtari e ndaluar. Arsyetimi i Komisionerit se dorëzimi i dokumenteve të pronësisë së shtëpive të rindërtuara, është “pohuar nga Bashkia Tiranë në infomacionin shpjegues bashkëlidhur shkresës me nr. prot. 2686/1 datë 26.01.2021” dhe në këto kushte jemi para veprimtarive të ndaluara, nuk rezulton i bazuar në ligj dhe prova.

7. Pala paditëse Partia Lëvizja Socialiste për Integrim në kërkesëpadi ka pretenduar se:

- Paditësi subjekti politik “Lëvizja Socialiste Për Integrim” (LSI), pretendon se Vendimi KAS, objekt gjykimi është i pabazuar në ligj dhe në prova dhe është marrë në

kundërshtim të plotë me nenet 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor, dhe në kundërshtim të plotë me vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.

- Anëtarët/përfaqësuesit e mazhorancës në KAS, kanë kryer një keqinterpretim dhe orientim jo të drejtë të dispozitave që sanksionon Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij lidhur me detyrimin që kanë subjektet e përcaktuara për të raportuara disa kategori të veprimtarive publike dhe për të mos kryer publikisht disa veprimtari të tjera, siç janë identifikuar në vendimin nr. 9 datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator.
- Kategoritë e veprimtarive të ndaluara në Vendimin Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator janë ndarë në 2 grupe dhe konkretisht: a) Veprimtaritë që nuk lejohet të mbështeten dhe promovohen që janë listuar në pikën 1.1 të nenit 3, për të cilat të gjitha Zyrtarët e Shtetit Shqiptar që ushtrojnë funksione ekzekutive, që nga Kryeministri e deri te zyrtari i rangut më të ulët kanë detyrimin të raportojnë pranë KQZ, sipas nenit 4 pika 4 të Vendimit Nr. 9/2020 për këto veprimtari dhe nëse ato konsiderohen të ndaluara nuk lejohet të zhvillohen dhe b) Veprimtari të ndaluara, që janë listuar në pikën 1.3 të nenit 3, të cilat nuk lejohet të zhvillohen në periudhën 4 muaj e deri në datën e zgjedhjeve, pra për këto veprimtari mjafton të konstatohet dhe provohet se janë kryer dhe automatikisht ato konsiderohen si veprimtari të ndaluara, dhe personat që i kanë kryer këto veprimtari automatikisht janë subjekt i sanksioneve administrative të parashikuara në nenin 10 të Vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator.
- Diferenca ndërmjet dy kategorive të veprimtarive të përcaktuara në pikat 1.1 dhe 1.3 të nenit 3 të Vendimit nr. 9/2020 është pikërisht fakti se për veprimtaritë e listuara në pikën 1.1, Institucioni përgjegjës raporton përpara KQZ për veprimtarinë publike që kërkon të zhvillojë dhe nëse KQZ e konsideron veprimtarinë publike të ndaluar, vendos ndalimin e saj, ndërsa, për veprimtaritë e parashikuara në pikën 1.3 të nenit 3 të Vendimit Nr.9/2020, sqarojmë faktin se ato janë automatikisht të ndaluara dhe mjafton të provohet se janë kryer brenda periudhës së ndaluar dhe automatikisht detyra e KQZ është të identifikojë personat dhe të dënojë me masat administrative përkatëse zyrtarët shkelës, kur shkelja e tyre nuk konsiderohet vepër penale.
- Pikërisht këtë qëllim ka pasur edhe ligjvënësi në Kuvendin e Shqipërisë kur ka miratuar ndryshimet në nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor, pra të garantojë një garë elektorale me mjete e armë të barabarta, duke parashikuar kushtëzime dhe ndalime mbi veprimtaritë caktuara.
- Në rastin konkret bazuar në analizën e fakteve dhe provave të depozituara në KQZ, argumentohet dhe provohet se: Veprimtaritë e denoncuara me nr. ID 353, 360, 362, 404, 406 dhe 580 të zhvilluara nga Kryetari i Bashkisë Tiranë, përbëjnë veprimtari publike për t'u promovuar në kuptim të nenit 92, pika 1, të Kodit Zgjedhor, dhe të neneve 2, shkronja "b", e 3, të vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator. Rezultoi e paprovuar në fakte dhe në prova që Bashkia Tiranë të ketë marrë masa aktive për të njoftuar në kohë KQZ-në me email apo me postë dhe pse në mungesë të kredencialeve për raportimin e aktiviteteve publike. Mosraportimi i tyre në KQZ ngarkon me përgjegjësi administrative Kryetarin e Bashkisë Tiranë.
- Dorëzimi i dokumenteve të pronësisë së shtëpive të rindërtuara, të pohuara nga Bashkia Tiranë në informacionin shpjegues bashkëlidhur shkresës me nr. prot., 2686/1 datë 26.01.2021, përbën veprimtari të ndaluar në kuptim të nenit 3, pika 1.3 shkronja "b" të vendimit nr. 9/2020, dhe ngarkon me përgjegjësi administrative Kryetarin e Bashkisë Tiranë.

- Arsyetohet se, pretendimet e parashtruara nga personi i tretë në këtë gjykim, provojnë se është shkelur vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator. Ky pranim bëhet nëpërmjet pasqyrimin publik që i është dhënë aktiviteteve nëpërmjet publicitetit në mediat më të mëdha në vend me iniciativë të Drejtorisë së Informacionit të Bashkisë Tiranë, e cila me e-mail zyrtar ka informuar këto media me qëllim pasqyrimin e këtyre lajmeve në rubrikat e ndryshme informative të hapësirave televizive apo të shkruara të tyre. Ky fakt është i sqaruar më sipër në pikat 5, 6 dhe 7.
- Referuar nenit 3 paragrafi “b” i vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ, “Veprimtari publike”, janë të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut, apo të medias në kuptim të pikës 1 të nenit 92 të Kodit Zgjedhor, të kryera nga subjektet e përcaktuara në këtë vendim, si dhe ato që kanë në agjendë informimin në periudhën katër mujore para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre”.
- Nga përgjigjet e marra nga mediat, lidhur me raportimin prej tyre të këtij aktiviteti, rezulton se njoftimi për aktivitetet është realizuar përmes zyrës së shtypit të bashkisë.
- Po kështu, edhe nëse në momentin real të zhvillimit të aktivitetit, nuk ka pasur prezent asnjë media, dërgimi i materialit të përgatitur prej vetë Bashkisë së Tiranës, përmes zyrës së shtypit të këtij institucioni, secilës prej tyre, vërteton qëllimin e informimit të publikut nëpërmjet medias për veprimtaritë e zhvilluara.
- Bazuar në parashikimet e nenit 2 të vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator dhe nenit 92 pika 1, të Kodit Zgjedhor përcaktohet detyrimi i institucioneve publike qendrore dhe vendore, si dhe agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore përfshirë edhe subjektin e denoncuar, të raportojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve, deri në ditën e zgjedhjeve.
- Sa më sipër, pala paditëse vlerëson Aktivitetet e denoncuara si aktivitete publike të ndaluara, të kryera nga Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj nga institucioni i Bashkisë Tiranë. 25 Data: 9 Shkurt 2021 Nr. 46, i konsideruar si subjekt raportues sipas nenit 92 të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, duhej të ishin raportuar në ndërfaqen e raportimeve të KQZ-së.
- Nga ana tjetër, Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj në cilësinë e subjekteve të identifikuar në nenin 3, pika 2 të vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, rezulton se e ka të ndaluar të dorëzojë/shpërndajë në veprimtari publike të akteve për regjistrimin e tokës bujqësore, çertifikatave të pronësisë, dhe çfarëdolloj titulli pronësie sipas legjislacionit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve;
- Në të gjitha aktivitetet e denoncuara nga LSI rezulton se Kryetari i Bashkisë Tiranë Z. Veliaj ka shpërndarë dokumenta pronësie dhe e ka deklaruar publikisht këtë fakt, në kundërshtim të hapur me nenin 3, pika 1.3, shkronja “b” e vendimit 9/2020 të Komisionit Rregullator në KQZ.
- Në rastin e ankesave të kryera nga subjekti LSI, pohohet nga vetë subjekti i ankimuar, dorëzimi i dokumenteve të pronësisë. Ky moment përbën veprimtari të ndaluar pasi veprimtaria ka përmbushur të dyja kushtet kumulative të përcaktuara në vendimin nr. 9/2020 (“...Shpërndarja në veprimtari publike të certifikatave të pronësisë sipas legjislacionit...”): a) karakteri publik/ informues; b) dorëzimi i certifikatave të pronësisë.

- Karakteri publik/ informues vërtetohet nga komunikimet e zyrës së shtypit të Bashkisë Tiranë të cilët dëshmojnë informimin e medias. Dorëzimi i çertifikatave të pronësisë, pohohet nga vetë subjekti ndaj të cilit bëhet ankimi.
- Përsa më sipër provohet se aktiviteti i datës 29.12.2020 pavarësisht faktit nëse duhej të ishte raportuar apo jo, përbën aktivitet të ndaluar nga vendimi 9/2020 i Komisionit Rregullator. Për sa më sipër, Kryetari i Bashkisë Tiranë z. Erion Veliaj mban përgjegjësi administrative, si drejtues i Bashkisë Tiranë, ndaj të cilat Kodi Zgjedhor i ngarkon detyra.
- Theksohet se, kërkesa ankimore e subjektit ankues e paraqitur në KAS nuk ishte në përputhje me elementët e domosdoshëm të formës të kërkuar në pikën 2 gërma a) dhe dh) të nenit 10 të Vendimit Nr. 3 datë 6.11.2020 të Komisionit Rregullator, e për pasojë KAS në përputhje me nenin 17 të Vendimit Nr. 3 datë 6.11.2020 dhe nenet 126 e vijues të Kodit Zgjedhor, duhet të kishte kthyer për plotësim kërkesën ankimore e cila ka mungesa të theksuara të elementeve të domosdoshëm të formës, në mbështetje të parashikimeve të gërmës c) të pikës 3 të vendimit të sipërcituar.
- Vendimi i KAS është marrë me tre vota pro, nga pesë vota të KAS, të pa mbështetur në ligj dhe në prova, ardhur si rrjedhojë e një interpretimi të gabuar të ligjit dhe të akteve të dala në zbatim të tij.
- Theksohet fakti se, tre anëtarët e caktuar nga mazhoranca në këtë Komision, kanë vendimuar në shkelje të dispozitave ligjore, duke disponuar me një vendim haptazi i pa mbështetur. Nëpërmjet tij KAS i ka hapur kështu rrugën e precedentit të gabuar trajtimi që ligjvënësi i ka bërë ndalimeve të caktuara në nenin 92 të Kodit Zgjedhor. Vullneti i tij (i ligjvënësit) nëpërmjet ndalimeve, në mbrojtje të parimeve demokratike të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, është shtjelluar më tej me Vendimin Nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
- Interpretimi i gabuar i bërë nga KAS lidhur me denoncimet e z. Veliaj i cili me të drejtë është sanksionuar nga KSHZ, sjell një në praktikë një precedent të rrezikshëm mbi të cilin nuk garantohet barazia e politikbërjes në periudhë zgjedhore, nuk garantohen proceset bazë të përfitimit të drejtë dhe të orjentimit të ndershëm të programeve elektorale dhe të qasjes me zgjedhësit, nuk garantohet fryma e ndryshimeve gjërësisht të pranuar dhe të konkluduara nga Këshilli Politik nga përfaqësuesit e subjekteve politike.
- Këto elementë të formës dhe përmbajtjes janë esencial për t'u marrë në shqyrtim nga Kolegji në mënyrë që vendimmarrja e tre anëtarëve të KAS të mos çënojë besimin te qytetarët, të mos çënojë parimet bazë të një procesi të mbështetur në ligj dhe në praktikat më të mira demokratike, të mos çënojë besimin e organizmave ndërkombëtar të cilët kanë shpenzuar shumë resurse të karakterit njërëzor dhe financiar për parashikimin e disa rregullave të qarta dhe të barabarta për të gjithë subjektet politike qofshin ato në mazhorancë apo në opozitë.

II. ARSYETIMI I KOLEGJIT:

8. Duke qenë se u paraqit kërkesë nga pala e paditur dhe personi i tretë lidhur me kompetencën që në fazën e kërkesave paraprake, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerësoi të marrë në shqyrtim kërkesën. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson të parashtojë se Kodi Zgjedhor (ligji nr.10019 datë 28.12.2008, i ndryshuar) sipas nenit 1 të tij, ka synim përcaktimin e rregullave lidhur me përgatitjen, zhvillimin, administrimin, mbikqyrjen dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve në Republikën e Shqipërisë. Përmes këtyre rregullave, synohet të garantohet zhvillimi i zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Në referencë të rregullave të parashikuara në Kodin Zgjedhor,

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve është pikërisht institucioni përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve dhe ndër të tjera zgjidh në rrugë administrative kërkesat apo ankesat që kanë lidhje me procesin zgjedhor. Në nenin 12 dhe vijues të Kodit Zgjedhor, janë evidentuar dhe rregulluar mënyra e funksionimit dhe kompetencat përkatëse të organeve drejtuese të KQZ-së, konkretisht Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionit Rregullator dhe Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve. Ndër të tjera, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve konsiderohet sipas Kodit Zgjedhor, organi kompetent për shqyrtimin e ankimimeve administrative dhe për vendosje të sanksioneve përkatëse për shkelje të ligjit zgjedhor.

9. Në Kodin Zgjedhor, në nenin 145 të tij, përcaktohet se: *“Subjektet zgjedhore kanë të drejtë të bëjnë ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë kundër vendimeve të KQZ-së, kur ato çënojnë interesat e tyre të ligjshëm brenda afatit të përcaktuar në nenin 152 të këtij Kodi....”*. Në interpretim të dispozitës së sipërcituar, Kolegji vlerëson se vetë ligjvënësi në parashikimet e kësaj dispozite, ka pasur si synim që Kolegji Zgjedhor të investohet nga subjekti zgjedhor duke marrë në shqyrtim vendimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, kur këto vendime çënojnë interesat e ligjshëm të subjektit zgjedhor.

Nisur nga sa më lart, Kolegji vlerëson se lënda që formohet nga gama e çështjeve për të cilat Kolegji mund të investohet për të disponuar më pas me një vendim, i referohet pikërisht rasteve kur subjekti zgjedhor ka qenë objekt i procedimit administrativ pranë Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (për çështjet që lidhen me kundravajtjet administrative të parashikuara nga K.Zgjedhor). Në vlerësim të Kolegjit, synimi i ligjvënësit pikërisht ky ka qenë, që subjekteve zgjedhore t'u garantohet e drejta për të pasur një garë të barabartë në zgjedhjet që zhvillohen dhe si garant i mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave tyre, në funksion gjithmonë të zhvillimit të zgjedhjeve të lira dhe demokratike, në vlerësim të Kolegjit, kompetenca e tij i referohet pikërisht këtyre rasteve të sipërcituara.

Në vlerësim të Kolegjit, nuk përbën objekt të lëndës së çështjeve që Kolegji mund të marrë në shqyrtim, gjithmonë në interpretim të Kodit Zgjedhor, rastet e procedimeve administrative pranë KQZ-së, të personave të tretë.

10. Kolegji vlerëson se ligjvënësi ka parashikuar se për kategori të caktuara mosmarrëveshesh, procedimi gjyqësor duhet të zhvillohet përpara një Gjykate, funksionimi i të cilës të ndihmojë që procesi të zhvillohet në mënyrë sa më efektive dhe brenda një afati të arsyeshëm në respektim edhe të nenit 6 të KEDNJ, nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 4 të K.Pr.Civile. Në vetvete, kompetenca është një kusht procedural i vlefshmërisë së procesit gjyqësor dhe i akteve të realizuara gjatë tij. Në bazë të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, janë krijuar Gjykatat administrative. Neni 7 gërmat “a” dhe “b” të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, përcakton dy kushte që një çështje të jetë në kompetencë lëndore të Gjykatave Administrative të cilat janë:

- *Mosmarrëvesha duhet të lindë gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative si dhe*
- *Organi me të cilin ka lindur mosmarrëveshja duhet të jetë “organ publik”.*

Në këtë sens, Kolegji vlerëson se nuk mund të investohet në shqyrtimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga subjekti Lëvizja Sociale për Integrim, referuar objektit të kërkimeve të saj, që

lidhet me kundërshtimin e një vendimmarrje të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve pranë KQZ-së, përmes të cilit është vendosur:

“Ndryshimin e vendimit nr. 46, datë 09.02.2021 “Për shqyrtimin administrativ të denoncimeve për shkelje të parashikuar në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator në KQZ ndaj kryetarit të bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj”;

Për pikën 1 të vendimit të KSHZ nr. 46/2021, shfuqizimin e sanksionit administrativ me gjobë ndaj z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë, në shumën 35 000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për shkelje të nenit 92 pikat 1, 2 e 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar për mosraportim të aktiviteteve publike;

Për pikën 2 të vendimit nr. 46/2021, të KSHZ, shfuqizimin e sanksionit administrativ me gjobë ndaj z. Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë në shumën 40 000 (dyzetë mijë) lekë për shkelje të nenit 3, paragrafi 1.3, shkronja “b”, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020....”.

Në kushtet, kur procedura administrative e ndjekur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve fillimisht dhe më pas Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (vendimmarrja e të cilit kundërshtohet me padinë e ngritur), i referohet një personi të tretë, jo subjekt zgjedhor, Kolegji vlerëson se nuk ka kompetencë lëndore për shqyrtimin e kësaj kërkesëpadie.

11. Në referencë të përcaktimeve të neneve 158 të Kodit Zgjedhor, duke qenë se Kolegji konstaton mungesë kompetence lëndore, disponon me vendim për pushimin e gjykimit të kërkesëpadisë së ngritur nga Lëvizja Sociale për Integrim. Në zbatim të nenit 158/2 i Kodit Zgjedhor, Kolegji vlerëson dërgimin e akteve për shqyrtim Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenet 158, 159 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Pushimin e gjykimit të çështjes me nr.2 regj.them. datë regjistrimi 22.02.2021, me palë paditëse Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, palë e paditur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, person i tretë Erion Veliaj, me objekt “Ndryshimin e vendimit nr.6 datë 16.02.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”, për mungesë të kompetencës lëndore të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

2. Dërgimin e akteve për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

3. Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

U shpall sot në Tiranë, më datë 04.03.2021.

GJYQTAR
Asim VOKSHI

GJYQTAR
Sokol IBI

GJYQTAR
Gentjan MEDJA

GJYQTARE
Alma KOLGJOKA

GJYQTARE
Esmeralda XHILI